



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

*Nr.132, Datë 16.08.2017*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “THE BLUE  
STAR” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 13 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 16.08.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të Shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat , “b”, “c”, “e”), është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” “d”), është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni tekniko - ekonomik (neni 9, pika 4.8, gërma “c”), është plotësuar tërësisht.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Neni 9, pika 2 gërma “a”, (Aktin e themelimit të shoqërisë);
- Neni 9, pika 2 gërma “d”, (Vërtetimin nga Gjykata);
- Neni 9, pika 4.8, gërma “a”/”d”, sasia e energjisë elektrike e parashikuar për tu tregtuar sipas viteve; gërma “b” kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e këtij aktiviteti; do të njoftohet subjekti që në bazë të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e Shoqërisë “THE BLUE STAR” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike për një afat 5 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.